



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Kryesia e Kuvendit

P-111

Prishtinë, më 27 maj 2013, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 27 MAJ 2013

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit, Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Glauk Konjufca, Petar Miletqi dhe Rasim Demiri, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Adem Grabovci, Ismet Beqiri, Liburn Aliu, Ardian Gjini, Myzejene Selmani, Sasha Milosavljeviq, Myfera Shinik dhe Goran Marinković.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Eshref Vishi dhe Skender Reçica.

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Sherif Konjufca;

Nga zyra e Presidentit: Amir Haradinaj,

Nga OSBE-ja: Floriana Shala dhe

Nga NDI-ja: Arben Kelmendi.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Ai propozoi që rendit të ditës t'i shtohen edhe dy pika shtesë.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 20 maj 2013,
2. Përgatitjet për mbledhjen plenare të radhës,
3. Shqyrtimi i propozimeve dhe kërkesave.

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 20 maj 2013

Kryesia e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 20 maj 2013.

2. Përgatitjet për mbledhjen plenare të radhës

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me vazhdimin e mbledhjes plenare, të filluar më 23 maj 2013, vendosi që ajo të mbahet të enjten, më 30 maj 2013, në orën 10:00, me këtë:

Rend dite

1. Votimi i raportit vjetor të punës së Zyrës së Rregullatorit për Ujësjellës dhe Kanalizim për vitin 2012,
2. Votimi i raportit vjetor të punës së Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave për vitin 2012,
3. Votimi i rekomandimeve nga debati parlamentar lidhur me gjendjen e pyjeve në Kosovë.

Ndërsa për mbledhjen plenare të radhës të mbahet më 30 maj, në orën 10:30, me këtë:

Rend dite

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për produktet e ndërtimit,
4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit treguesit gjeografikë,
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për odat e profesionistëve shëndetësorë,
6. Shqyrtimi i raportit vjetor mbi gjendjen në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës për vitin 2011,
7. Ratifikimi i vendimeve të Qeverisë së Republikës së Kosovës për themelimin e

universiteteve publike në Gjakovë, në Gjilan dhe në Mitrovicë, si institucione publike të arsimit të lartë,

8. Miratimi i Statutit të Universitetit “Ukshin Hoti” në Prizren,

9. Miratimi i Statutit të Universitetit “Haxhi Zeka” në Pejë,

10. Miratimi i buxhetit të Komisionit Hetimor Parlamentar.

Mbledhja plenare më 31 maj 2013, në orën 10:00, me këtë:

Rend dite

1. Debat parlamentar lidhur me të drejtat elementare të shqiptarëve në Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë, sipas kërkesës së deputetit Lutfi Haziri, i mbështetur edhe nga deputetët nënshkrues.

Mbledhja plenare më 31 maj 2013, në orën 12:00, me këtë:

1. Shënimi i 14-vjetorit të rënies së Heroit të Kosovës, Rasim Kiçina, dhe 24-vjetorit të rënies së Dëshmorit të Kosovës, Ali Ajeti.

3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe i kërkesave

1. Propozimi i GP të SLS-së për zëvendësimin e anëtarëve në komisione parlamentare

Për kërkesën e lartshënuar diskutuan: Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit; Xhavit Haliti, Sabri Hamiti dhe Petar Miletiq, nënkryetarë të Kuvendit; Adem Grabovci, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Ardian Gjini, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së; Goran Marinković, në emër të Grupit Parlamentar “ZB”, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryesia, me propozim të nënkryetarit të Kuvendit, z. Petar Miletiq, kërkesën e lartshënuar e shtyu për mbledhjen e radhës të Kryesisë, me qëllim të konsultimeve shtesë ndërmjet Grupit Parlamentar të SLS-së dhe të Grupit Parlamentar të ZB-së.

3. Kërkesa e Grupit Parlamentar “Zajednička Budućnost” për përfaqësim në strukturat relevante të Kuvendit

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me kërkesën e lartshënuar, konstatoi se Grupi Parlamentar “Zajednička Budućnost” dhe Grupi Parlamentar SLS duhet të merren vesh për përfaqësimin e deputetëve nga radha e tyre në komisionet parlamentare, ndërsa për plotësimin e kushteve të punës ngarkohet Administrata e Kuvendit që të krijojë kushte pune si për grupet e tjera parlamentare.

4. Njoftimi i deputetes Vesna Mikiq se ajo i është bashkuar Grupit Parlamentar “Zajednička Budućnost”

Kryesia u njoftua nga deputetja Vesna Mikiq se prej datës 14 maj 2013 i është bashkangjitur Grupit Parlamentar “Zajednička Budućnost”.

5. Njoftimi i z. Blerim Rexha për dorëheqje nga pozita e kryetarit të Bordit të Agjencisë së Privatizimit dhe e znj. Dardane Peja për dorëheqje nga pozita e anëtares së Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit

Kryesia u njoftua me dorëheqjen e z. Blerim Rexha nga pozita e kryetarit të Bordit të Agjencisë së Privatizimit, si dhe me dorëheqjen e znj. Dardane Peja nga pozita e anëtares së Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

Për njoftimin e lartshënuar diskutuan: Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit; Xhavit Haliti dhe Sabri Hamiti, nënkryetarë të Kuvendit; Ismet Beqiri, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së; Ardian Gjini, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

6. Kërkesa për lejimin e udhëtimit zyrtar në Gjermani

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

1. Lejohet udhëtimi i anëtarëve të Komisionit Parlamentar për Legjislacion, në këtë përbërje: Arben Gashi, Behar Selimi dhe Ardian Gjini, për pjesëmarrje në Konferencën e tretë ndërkombëtare të komisioneve parlamentare, me temë “Procesi i legjislacionit - Roli dhe ndikimi i institucioneve pjesëmarrëse”, e cila do të mbahet në Gjermani, prej datës 30 qershor, deri më 2 korrik 2013.

2. Shpenzimet e akomodimit për të lartshënuarët në pikën një (1) të këtij vendimi mbulohen nga organizatori - Fondacioni gjerman për bashkëpunim ndërkombëtar në drejtësi (IRZ), ndërsa shpenzimet e udhëtimit dhe mëditjet shtesë (30%) mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Kosovës.

Pikat shtesë:

1. Rekomandimi i Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me kërkesën e Komisionit Hetimor Parlamentar për lejimin e mjeteve buxhetore

Rekomandimin e lartshënuar, Kryesia e radhiti në rend të ditës për mbledhjen plenare të radhës, që do të mbahet më 30 maj 2013.

2. Kërkesa e Qeverisë për shqyrtimin e raportit të Komisionit Qeveritar për Privatizim

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me kërkesën e lartshënuar, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Ngarkohet Komisioni Parlamentar për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri që ta shqyrtojë raportin e Komisionit Qeveritar për Privatizim dhe Kuvendit t’ia paraqesë raportin me rekomandime.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën 12:05 minuta.

Kryetari i Kuvendit
Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi: Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale